

Aftësia e të rriturve për të shkruar dhe lexuar

Bashkohuni me komunitetin e EPALE me më shumë se 30 000 specialistë të të nxëniet për të rritur për të vlerësuar, komentuar dhe kontribuar!

Të dashur kolegë të EPALE,



Tema jonë për muajin shtator kishte të bënte me **aftësinë e të rriturve për të shkruar dhe lexuar**. Gjatë kësaj kohe ekipet kombëtare dhe komuniteti i EPALE kanë publikuar një sërë studimesh, artikujsh, raportesh dhe burimesh të tjera frymëzuese. Ju mund t'i gjeni ato në faqen tonë të posaçme **Aftësitë themelore** (përmbajtja ndryshon sipas versionit të gjuhës).

[Shihni një përmbledhje të fokusit të EPALE gjatë muajit shtator, të përgatitur nga Koordinatori Tematik David Mallows.] (në gjuhën angleze)

Nga data 4 deri më 7 shtator EPALE i ftoi të gjithë që të bashkëndanin pikëpamjet e tyre në lidhje me aftësitë e nevojshme të të rriturve për të shkruar dhe lexuar si edhe në lidhje me faktorët që kontribuojnë për një politikë efektive në këtë fushë. Diskutimi i ndezur u moderua nga Koordinatori Tematik i EPALE **David Mallows** në bashkëpunim me **Rrjetin European të Aftësive Themelore (RREATH)** (**linku është i jashtëm**). Gati 50 pjesëmarrës nga 21 vende ndanë mendimet e tyre me më shumë se 220 komente.

Nëse e keni humbur diskutimin, mos u shqetësoni - **ende është e mundur që t'i shihni komentet dhe temat e diskutuara** (në gjuhën angleze).

Aftësia për të shkruar dhe lexuar dhe Inisiativa 'Rrugët për Rritjen e Aftësive' (në gjuhën angleze, frënge)

Koordinatori Tematik i EPALE, **Andrew McCoshan**, e hodhi vështrimin tek pyetjet që duhen marrë në konsideratë kur mendojmë për aftësinë për të shkruar dhe lexuar në kontekstin e Inisiativës së BE 'Rrugët për Rritjen e Aftësive'.

Promovimi i aftësisë për të shkruar dhe lexuar tek të rriturit me kualifikim të ulët në Europën Juglindore dhe efekti i partneriteteve të të nxëniet (në gjuhën angleze, rumune)

George K. Zarifis foli për sfidat e hasura nga shumë vende të Europës Juglindore kur flitet për zbatimin e politikave për rritjen e numrit të nxënësve të rritur në moshë, veçanërisht në programet e aftësimin për të shkruar dhe lexuar.

Çfarë nënkuptojmë me 'aftësi për të shkruar dhe lexuar'? (në gjuhën gjermane, angleze, spanjolle, frënge, italiane, polake)

Koordinatori tematik **David Malloës** ka reflektuar në lidhje me kuptimin e termit 'aftësi për të shkruar dhe lexuar' si edhe me arsyen përse ky term ka qenë subjekt i një debati të pafund.

Aftësia për të shkruar dhe lexuar e parë nga perspektiva europiane (në gjuhën frënge)

Sylvie Pinchart nga komuniteti frëngjisht-folës "Lexo dhe Shkruaj" në Belgjikë ka bërë një përmbledhje të punës që po bën Bashkimi Europian për të nxitur aftësimin e të rriturve për të shkruar dhe lexuar.

Lajme nga mbarë Europa



Shumë gjëra kanë ndodhur gjatë muajit shtator në sektorin e të rriturve në të gjithë Europën:

- Qeveria daneze ka njoftuar që po planifikon një **reformë të arsimit dhe formimit profesional (AFP)** për ta bërë më të lehtë pjesëmarrjen e të rriturve në AFP (në gjuhën daneze).
- **Në Holandë u lançua një fushatë e re** për të rekrutuar më shumë mësues gjuhe dhe trajnues për migrantët me aftësi të ulëta në shkrim dhe lexim në gjuhën hollandeze (në gjuhën hollandeze).
- Ndërkohë në Slloveni, **është shpallur një thirrje për propozime** për Çmimin e vitit 2017 për Nxitjen e të Nxënimit dhe të Njohurive të të Rriturve (në gjuhën sllovene).

Bashkohuni tani!

Mos harroni të regjistroheni në EPALE që të keni mundësi për të bashkëndarë opinionet tuaja mbi këto postime. [Bashkohuni tani](#) dhe bëhuni pjesë e komunitetit të përbërë nga 30 000 profesionistë të të Nxënimit për të Rritur.